
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FI. ME. GI.” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FI. ME. GI.” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“FI. ME. GI.” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“FI. ME. GI.”**, zoterohet nga ortaket:

1. **Z. MARCO MENICHINI**, shtetas italian, i lindur ne Pistoia (PT), me 19.09.1961, rezident ne Buggiano, Rruga Pisa 4, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. AX5115634.
2. **Z. Antonio Giorgi**, shtetas italian, lindur ne Pistoia (PT), me 24.05.1968 dhe rezident ne Massa e Cozzile (PT), Rruga Colombo 14, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. CA79551AU.

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“FI. ME. GI.” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“FI. ME. GI.” Sh.p.k.**

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane, Albania.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**FI. ME. GI.**” Sh.p.k ka si objekt blerjen, mbajtjen, administrimin dhe shitjen e pjesëmarrjeve, kuotave shoqërore, aksioneve dhe titujve të tjerë në shoqëri ose ente, qoftë sipas së drejtës shqiptare apo të huaj. Për këtë qëllim, shoqëria mund të:

1. Blejë dhe mbajë pjesëmarrje, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, në shoqëri të themeluara ose në themelim, si shqiptare ashtu edhe të huaja;
2. Kryejë aktivitetin e administrimit dhe menaxhimit të pjesëmarrjeve të mbajtura, përfshirë dhënien e financimeve, garancive dhe ndihmës financiare për shoqëritë ku merr pjesë;
3. Marrë pjesë në operacione të jashtëzakonshme si bashkime, ndarje, transformime, blerje, ndërmarrje të përbashkëta dhe forma të tjera bashkëpunimi dhe/ose investimi;
4. Kryejë veprimtari koordinimi teknik, financiar dhe administrativ të shoqërive ku merr pjesë;
5. Kryejë të gjitha operacionet e nevojshme dhe/ose të dobishme për realizimin e objektit social, përfshirë blerjen, qiranë, shitjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme, të luajtshme dhe të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo aktivitet tjetër të lidhur ose ndihmues për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 10.000 Leke (dhjetemije Leke), i ndare në 2 (dy) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. **Z. MARCO MENICHINI**, shtetas italian, i lindur ne Pistoia (PT), me 19.09.1961, rezident ne Buggiano, Rruga Pisa 4, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. AX5115634 i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 5,000 leke (pese mije) e cila perfaqeson 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
2. **Z. Antonio Giorgi**, shtetas italian, lindur ne Pistoia (PT), me 24.05.1968 dhe rezident ne Massa e Cozzile (PT), Rruga Colombo 14, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. CA79551AU, i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 5,000 leke (pese mije) e cila perfaqeson 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**FI. ME. GI.**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, eshte emeruar:

MARCO MENICHINI, te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe i identifikuar me karte identiteti Nr. AX5115634.

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT


Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater) ekzemplare, 2 (dy) ne gjuhen shqipe dhe 2 (dy) ne gjuhen italiane duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 17.09.2024

**ORTAKET E SHOQERISE
c“FI. ME. GI.” Sh.p.k.**

Z. Menichini Marco



Z. Giorgi Antonio

